



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 29.03.2022)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan (relatore znj. Marçela Shehu) *(seancë e shtyrë nga mbledhja e datës 9 mars).*

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 14:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Irena Plaku** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtare)
- 10. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 2. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. {...}, Inspektor magjistrat i komanduar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në sallë).**
- 5. Mimoza Koçiu, Këshilltare për median pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.**
- 6. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 8. Albana Karapanço, PwC**
- 9. Staf administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan (relatore znj. Marçela Shehu) (*seancë e shtyrë nga mbledhja e datës 9 mars*).

**Naureda Llagami:** Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 29 mars 2022.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor sot do të shqyrtohen 9 çështje.

Çështja e parë është zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, seancë dëgjimore e cila është shtyrë nga mbledhja e datës 09.03.2022.

Ftojme palët në sallë.

*(Futet në sallën e mbledhjeve zonja {...}, Inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.)*

**Naureda Llagami:** E pranishme nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka ardhur zonja {...}, me detyrë Inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet autorizimit të lëshuar me nr. {...} prot., datë 14.02.2022.

Ndërkohë, nga ana e magjistratit është depozituar ditën e sotme kërkesa për shtyrjen e seancës dëgjimore e cila ishte programuar të bëhej sot në Këshillin e Lartë Gjyqësor, dhe argumenti i dhënë nga magjistrati është, se është në pamundësi për të qenë në këtë seancë dëgjimore, duke i bashkëlidhur kërkesës edhe raportin për paaftësi të përkohshme në punë.

Lidhur me vijimin e seancës dëgjimore, në kushtet që magjistrati na ka përcjellë edhe raportin, nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ... ?

*{...}*: Duke qenë se edhe kësaj here ai justifikohet dhe ka një dokument që lidhet me gjendjen e tij shëndetësore, që e mendoj faktor objektiv për të mos na mundësuar seancën e sotshme, mendoj që të shtyhet në një ditë tjetër, që është në vlerësimin tuaj. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Duke parë kalendarin e Këshillit, nga ana e relatores?

**Marçela Shehu:** Edhe unë vlerësoj që kërkesa e gjyqtarit është e shoqëruar edhe me dokumentin përkatës justifikues lidhur me arsyet e mosparaqitjes dhe do ta lë në vlerësim të Këshillit datën dhe orën e seancës së ardhshme. Mund të propozoja datën 20 prill, nëse edhe për kolegët është një datë e përshtatshme, ora 11:00, 12:00, si ta vlerësojnë kolegët.

**Naureda Llagami:** Do ishte më mirë ora 13:00?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë shtyhet zhvillimi i seancës dëgjimore me datë 20 prill, ora 13:00.

Faleminderit!

*(Largohet nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Mbledhja vijon me dy çështjet të cilat do të trajtohen vetëm në prezencën e anëtarëve të Këshillit, për të vijuar më tej me rendin e ditës nëpërmjet platformës “online”.)*

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 29.03.2022)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 14:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |

<sup>1</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta në rendin e ditës.

9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
10. *Marçela Shehu* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
2. *Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Viojmë me mbledhjen e Këshillit.

Kalojmë në çështjen e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar...”. Për më shumë detaje fjalën ia jap znj. Marçela Shehu.

*Marçela Shehu:* Faleminderit, Kryetare!

Me cilësinë e relatores si dhe me miratim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës lidhur me procedurën e realizuar, është paraqitur për shqyrtim mbledhjes plenare projektvendimi dhe relacioni për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me

verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidates për në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, znj. {...}.

Lidhur me procedurën e verifikimit:

Me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Në këtë procedurë ngritjeje në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afati i kandidimit është përcaktuar “deri më datë 16.04.2021”.

Brenda afatit ligjor, lidhur me këtë kandidim, ka kandiduar edhe kandidatja zonja {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, aktualisht e komanduar si Këshilltare ligjore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me vendimin nr. 179, datë 29.04.2021, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 123, nr. 125, nr. 127 dhe nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për këto pozicione të lira.

Pas procedurave të shortit, jam caktuar si relatore për kandidaten zonjën {...}.

Brenda afatit të përcaktuar, kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidates, në kuadër të ngritjes në detyrë, në kushtet kur kandidatja ishte subjekt rivlerësimi “ex officio” sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe kur referuar nenit 162, pika 7, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 57, pika 11, të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, për kandidatët që aplikojnë në

procedurat e ngritjes në detyrë për në gjykatat e specializuara, verifikimi i pasurisë dhe figurës bëhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit sipas Ligjit nr. 84/2016, çka përcaktohet edhe në Kreun X, Seksioni A, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. {...} prot., datë 06.05.2021, i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidatës.

Më datë 30.04.2021, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr.75/2019, në rrugë elektronike, kandidatës iu dërgua Autorizimi “Për verifikimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe Deklarata “Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale”, sipas pikës 6, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr.75/2019, meqenëse verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidatë do të kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Brenda afatit pesëditor, kandidatja ka paraqitur rregullisht dokumentacionin e kërkuar.

Për këtë kandidatë, është kërkuar informacion pranë strukturës së posaçme të Këshillit, në lidhje me verifikimet e kryera në zbatim të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

Vlen të përmendet se, me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në gjykatat e specializuara, kjo me qëllim për të ruajtur funksionalitetin e tyre, Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kritereve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Edhe për kandidaten {...} është ndjekur i njëjti standard.

Bazuar në sa është parashtruar në pikën 11, të këtij vendimi, Këshilli, në pikën 9, të vendimit të tij nr. 123, datë 01.04.2021, pra në vendimin e hapjes së procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë ku ka kandiduar znj. {...}, përcaktoi se: “Për



kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b”, “ç” dhe “d” të pikës 5 të këtij vendimi, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional:...”.

Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, “c”, “ç” dhe “d”, të këtij vendimi të Këshillit, përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përcaktohen në pikën 3 të nenit 8, në shkronjën “b” të pikës 2 dhe pikën 3 të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; b) Kandidati duhet të japë pëlqimin (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; ...; ç) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; d) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar”.

Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të katër kriterëve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që janë kriteri i “përvojës profesionale minimale”, i “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe i “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga institucionet kompetente.

Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidaten znj. {...} në lidhje me katër kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të përmendur më lart, Këshilli, me vendimin nr. 244, datë 09.06.2021, ka vendosur:

“4. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 123, datë 01.04.2021, të 4 kritereve formale që cituam më sipër.

5. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndërkohë, në lidhje me kriteret e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, rezulton se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi mori në shqyrtim në seancë dëgjimore, më datë 13.01.2022, çështjen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit {...}, me vendimin nr. 502, datë 17.01.2022, ka vendosur:

“1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit, Komisionerit Publik, etj. ...”

Vendimi më lart i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rezulton të ketë marrë formë të prerë më datë 25.02.2022, pasi nuk u ankimua.

Lidhur me rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe të figurës:

Neni 48, pika 7 dhe pika 8, e Ligjit për Statusin, përcakton se: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”. Ndërkohë, neni 162, pika 7, e këtij ligji, përcakton se: “7. Këshilli i Lartë Gjyqësor ngre në detyrë pa vonesë gjyqtarët që kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit në një pozicion të lirë në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, me qëllim për të siguruar numrin minimal të gjyqtarëve të përcaktuar për këto gjykata në ligjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"” .

Kurse neni 57, pika 11, i Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, përcakton se: “Përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në pikën 6, të nenit 6, dhe pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, për një periudhë 4-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për gjyqtarë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ose prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, si

dhe familjarëve të afërt të tyre, bëhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, dhe ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të funksionarëve të sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë". Një gjyqtar apo prokuror, që ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, konsiderohet se e përmbush kushtin e sigurisë, të parashikuar në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji. Vetëm pas kalimit me sukses të procesit të rivlerësimit, me vendim përfundimtar, ata mund të kualifikohen për t'u përzgjedhur si gjyqtar në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose prokuror në Prokurorinë e Posaçme.

Përcaktimet ligjore si më lart në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë materializuar në aktin nënligjor të Këshillit, vendimin nr.75/2019. Në këtë akt nënligjor, pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", janë subjekt rivlerësimi kalimtar "ex officio", rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidonin për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

Konkretisht, në Seksionin A, Kreu X, të vendimit nr.75/2019, titulluar "Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve për në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", përcaktohej se (sepse ky vendim i Këshillit tashmë ka pësuar ndryshime por që nuk afektojnë pozitën e kandidates, për sa kohë kandidimi i saj është bërë në kohën kur ishte në fuqi rregullorja e Këshillit, e pandryshuar): "1. Kandidatët për në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilët i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, për sa kohë vijon funksionimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të Seksionit C të Kreut IX të këtij vendimi. 2. Vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo për këta kandidatë, sa i përket verifikimit të pasurisë dhe të figurës, do të mbështetet në vendimin e dhënë nga organet e rivlerësimit sipas Ligjit nr. 84/2016. 3. Vetëm kandidatët

që kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, me vendim përfundimtar, mund të kualifikohen për t'u përzgjedhur si gjyqtarë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar...”.

Sa sipër, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për t'u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Përfundimisht, për një periudhë 4-vjeçare nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 95/2016, vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo për këta kandidatë, sa i përket verifikimit të pasurisë dhe të figurës, do të mbështetet në vendimin përfundimtar të dhënë nga organet e rivlerësimit.

Rezulton se kandidatja, znj. {...}, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar gjatë kohës që ka kandiduar për ngritjen në detyrë për në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ajo është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar, pikërisht me vendimin nr. {...}, datë 17.01.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar më datë 25.02.2022. Për rrjedhojë, vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo të kandidatës znj. {...}, sa i përket verifikimit të pasurisë dhe të figurës, do të mbështetet në vendimin përfundimtar të dhënë nga organet e rivlerësimit sipas Ligjit “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nuk po citoj në detaje konkluzionet e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për sa kohë kandidatja është kualifikuar dhe ka konkluzione konfirmuese për të gjitha kriteret e vlerësimit (pasurisë, figurës dhe të aftësive profesionale).

Konkluzione përfundimtare:

Për sa më sipër, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten dhe për verifikimin e pasurisë së kandidatës, duke qenë se Këshilli bazohet në vendimmarrjen e KPK-së, me propozimin e relatores dhe me miratim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i propozohet Këshillit, tashmë edhe pas miratimit të vendimit të parë për verifikimin e kriterëve formale, që të konkludojë përfundimisht me kualifikimin e kandidatës znj. {...}, dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 123, datë 01.04.2021.

Gjithashtu propozohet që vendimi nr. 244, datë 09.06.2021, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Ky është projektvendimi që i paraqitet për shqyrtim dhe miratim mbledhjes plenare.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, ftoj kolegët në votimin e projekt-aktit, nëse nuk kanë ndonjë diskutim.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 123, datë 01.04.2021.

2. Vendimi nr. 244, datë 09.06.2021, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 29.03.2022)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).<sup>2</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 14:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Irena Plaku** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)

<sup>2</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta në rendin e ditës.

9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
10. *Marçela Shehu* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
2. *Lorena Gerverni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e dytë që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Hallunaj.

*Dritan Hallunaj:* Atëherë, në lidhje me kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117, nr. 118, nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, po parashtroj gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimet që janë bërë për sa i përket pasurisë dhe figurës.



Me vendimin nr.117, nr. 118 dhe nr. 119 të datës 01.04.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”.

Në këto procedura ngritjeje në detyrë, afati i kandidimit është përcaktuar “deri më datë 16.04.2021”.

Brenda afatit të kandidimit, për pozicionet e lira, ka kandiduar gjyqtarja znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktualisht e komanduar si “pedagoge e brendshme” pranë Shkollës së Magjistraturës.

Me vendimin nr. 178, datë 29.04.2021, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117, nr. 118, nr. 119 dhe nr. 120, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira...

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:... 3. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...}. ....”.

Brenda afatit të përcaktuar, kandidatja, pasi i është bërë e ditur fillimi i procedurës së verifikimit, nuk parashtrroi ndonjë pretendim.

Në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidates, në kuadër të ngritjes në detyrë, në kushtet kur kandidatja është subjekt rivlerësimi “ex officio” sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, proces ky që nuk ka përfunduar për këtë kandidate, si dhe kur referuar nenit 162, pika 7, të Ligjit nr.96/2016 dhe të Ligjit nr.95/2016, për kandidatët që aplikojë në procedurat e ngritjes në detyrë për në gjykatat e specializuara, verifikimi i pasurisë dhe figurës bëhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit sipas Ligjit nr.84/2016, çka përcaktohet edhe në Kreun X, Seksioni A, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (i azhurnuar), Këshilli i Lartë Gjyqësor, me

shkresën nr. {...} prot., datë 06.05.2021, i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidates.

Më datë 30.04.2021, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërgua Autorizimi “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe Deklarata “Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale”, sipas pikës 6, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit nr. 75/2019, meqenëse verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidate do të kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për këtë kandidate, është kërkuar informacion pranë strukturës së posaçme të Këshillit, në lidhje me verifikimet e kryera në zbatim të Ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, meqenëse në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kandidatja ka qenë gjyqtare dhe i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji.

Vlen të përmendet se, me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në gjykatat e specializuara, kjo me qëllim për të ruajtur funksionalitetin e tyre, Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së renditjes dhe ngritjes në detyrë të kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit për kriteret formale të kandidimit, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kritere do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas verifikimit të të

gjithë kriterëve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

Sipas pikës 9, të vendimeve të Këshillit nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021, është përcaktuar se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b”, “ç” dhe “d” të pikës 5 të këtij vendimi, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a” dhe “b”, të vendimeve të Këshillit nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021, përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përcaktohen në pikën 3 të nenit 8, në shkronjën “b” të pikës 2 dhe pikën 3 të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale; b) Kandidati duhet të japë pëlqimin (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Nga ana tjetër, në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 5, të këtyre vendimeve, përcaktohet se: ç) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; d) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.”

Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidaten znj. {...} në lidhje me katër kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli me Vendimin nr. 228, datë 02.06.2021, ka vendosur:

“1.Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive

bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021.”

Ndërkohë, në lidhje me kriteret e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, në shkronjën “c”, pika 5, të vendimeve të Këshillit nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021, përcaktohet se: “Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019.

Rezulton se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi ka marrë në shqyrtim në seancë dëgjimore, çështjen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit {...}, me vendimin nr. {...}, datë 15.12.2021, ka vendosur: “1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. 2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. 3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.”

Vendimi më lart i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rezulton të ketë marrë formë të prerë më datë 09.02.2022, pasi nuk u ankimua .

Rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe të figurës:

Neni 48, pika 7 dhe pika 8, të Ligjit për Statusin, përcakton se: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”. Ndërkohë, neni 162, pika 7, i këtij ligji,

përcakton se: “7. Këshilli i Lartë Gjyqësor ngre në detyrë pa vonesë gjyqtarët që kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit në një pozicion të lirë në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me qëllim për të siguruar numrin minimal të gjyqtarëve të përcaktuar për këto gjykata në ligjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"”.

Kurse neni 57, pika 11, i Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, përcakton se: “Përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në pikën 6, të nenit 6, dhe pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, për një periudhë 4-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për gjyqtarë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, si dhe familjarëve të afërt të tyre, bëhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, dhe ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të funksionarëve të sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë". Një gjyqtar apo prokuror, që ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, konsiderohet se e përmbush kushtin e sigurisë, të parashikuar në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji. Vetëm pas kalimit me sukses të procesit të rivlerësimit, me vendim përfundimtar, ata mund të kualifikohen për t'u përzgjedhur si gjyqtar në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose prokuror në Prokurorinë e Posaçme.

Përcaktimet ligjore si më lart në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë materializuar në aktin nënligjor të Këshillit, vendimin nr. 75/2019 (i azhurnuar) . Në këtë akt nënligjor, duke pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë subjekt rivlerësimi kalimtar “ex officio”, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidonin për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

Konkretisht, në Seksionin A, Kreu X, të Vendimit 75/2019, titulluar “Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve për në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”, përcaktohet se: “1. Kandidatët për në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilët i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, për sa kohë vijon funksionimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të Seksionit C të Kreut IX të këtij vendimi. 2. Vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo për këta kandidatë, sa i përket verifikimit të pasurisë dhe të figurës, do të mbështetet në vendimin e dhënë nga organet e rivlerësimit sipas Ligjit nr.84/2016. 3. Vetëm kandidatët që kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, me vendim përfundimtar, mund të kualifikohen për t’u përzgjedhur si gjyqtarë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar...”.

Sa më sipër, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për t’u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Përgjithësisht, për një periudhë 4-vjeçare nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.95/2016, vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo për këta kandidatë, sa i përket verifikimit të pasurisë dhe të figurës, do të mbështetet në vendimin përfundimtar të dhënë nga organet e rivlerësimit sipas Ligjit “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Rezulton se kandidatja, znj. {...}, i është nënshtruar këtij procesi gjatë kohës që ka kandiduar për ngritjen në detyrë për në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ajo është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar, pikërisht me vendimin nr. 488, datë 15.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar më datë 09.02.2022. Për rrjedhojë, vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo të kandidates znj. {...}, sa i përket verifikimit të pasurisë dhe të figurës, do të mbështetet në vendimin përfundimtar të dhënë nga organet e rivlerësimit sipas Ligjit “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në vendimin nr. 488, datë 15.12.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndër të tjera, ka konkluduar se:

“Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë: “... 15.2 Trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, vlerëson se për faktet dhe rrethanat e rezultuara në vijim, subjekti ka shpjeguar bindshëm veprimet bankare të kryera në kohën kur ka qenë studente në Shkollën e Magjistraturës, duke deklaruar kështu me vërtetësi e saktësi lidhur me to. Konkludimi më sipër është rezultat i faktit që: (i) subjekti, në kohën e kryerjes së transaksioneve, ka qenë studente dhe jo në marrëdhënie pune; (ii) përgjatë hetimit në tërësi të rivlerësimit të subjektit është trajtuar situata financiare e familjes së origjinës së subjektit, përfshirë edhe të ardhura e krijuara nga aktiviteti i ushtruar nga njerku i saj; (iii) përgjithësisht, në trajtimin e pasurive në këtë vendimmarrje rezultoi se familja e origjinës së subjektit kishte pasur të ardhura për ta ndihmuar me huadhënie; (iv) shuma 8.000 euro e tërhequr nga subjekti korrespondon ekzaktesisht me shumën e dhënë në favor të porosisë së apartamentit nga familja e origjinës; si dhe (v) në kohën kur kanë ndodhur veprimet vizat e udhëtimit jashtë vendit ende nuk ishin liberalizuar dhe se për përfitimin e tyre pa dyshim kërkoheshin garanci të ndryshme. ...”

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës: “... Nga hetimi i kryer nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.....

Në përfundim të rivlerësimit për kontrollin e figurës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit {...} arrin nivel të besueshëm, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.”

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të aftësive profesionale: “... Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, ..., çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë shkak konsiderohet “i aftë”.”

Konkluzion përfundimtar: “ ... a) Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e saj, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

c) Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional...”.

Përveç sa më sipër, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, në kushtet kur kjo candidate ka qenë magjistrate në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidatja i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Për rrjedhojë, informacioni iu kërkua Strukturës së Posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit informacioni u dërgua me shkresën nr. {...} prot., datë 20.05.2021, ku për kandidaten {...} është bërë me dije se: – ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 25.04.2016; - formulari është regjistruar me numrin unik...; – formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare web të KLGJ-së; – nuk ka të dhëna të deklaruara që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara me ligj; – Sektori i Gjendjes Gjyqësore, personi rezulton (e padënuar) nga Gjykatat Penale Shqiptare; – nga Sektori i Gjendjes Civile, personi rezulton se (nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile); – deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

Sa më sipër, nga verifikimi i kriterit të pasurisë dhe figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.



Përfundimisht, duke vlerësuar të plotë procedurën dhe verifikimet e kryera për kandidaten znj. {...}, në lidhje me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës për kandidimin e saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira, të shpallur me vendimet e Këshillit nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021, relatori ia parashtroi rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në mbledhjen e datës 03.03.2022, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plota verifikimet për kandidaten sa i përket pasurisë dhe të figurës, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021 ose skualifikimin e kandidates dhe përjashtimin e saj nga kjo procedurë ngritjeje në detyrë.

Është paraqitur edhe projektvendimi përkatës, kështu që jam i hapur për çdo pyetje apo diskutim që mund të kenë anëtarët. Në të kundërt, të vijojmë me procedurën.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Hallunaj!

Nëse nuk kemi diskutim nga kolegët, kalojmë në procesin e votimit të projekt-aktit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 117, nr. 118 dhe nr. 119, datë 01.04.2021.

2. Vendimi nr. 228, datë 02.06.2021, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 29.03.2022)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përhshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2021, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 14:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

*10. Marçela Shehu* (anëtare)

*11. Yllka Rupa* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Lorena Gerverni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2021, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2021, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë. Për më shumë detaje, fjalën ia kaloj zonjës Ukperaj për relatimin e projekt-aktit.

*Brikena Ukperaj:* Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 535, nr. 536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, ka vendosur hapjen e procedurave për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës administrative dhe dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile.

Pas mbarimit të afatit të aplikimit për të gjitha pozicionet e lira të shpallura në Gjykatën e Lartë, është zhvilluar procedura e verifikimit për plotësimin nga kandidatët aplikues të tre kritereve të kandidimit sipas përcaktimeve të vendimit nr.75, datë 23.5.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”. Në përfundim të procedurës së verifikimit të tre kritereve të kandidimit, përkatësisht “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, për tre kandidatë, Këshilli ka vendosur vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e lira të shpallura në Gjykatën e Lartë.

Lidhur me procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për ngritje në detyrë, në secilin prej vendimeve të shpalljes së pozicioneve të lira për ngritje në detyrë parashikohet se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave përkatëse, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional: a) sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 dhe Vendimit të tij nr. 264, datë 21.11.2019, për kandidatin në një pozicion në sistemin gjyqësor;...”.

Sa më sipër, bazuar në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve, por edhe në Programin e Vlerësimeve të miratuar me vendimin nr. 645, datë 23.12.2020, Këshilli duhet të fillojë me përparësi procedurën e përshpejtuar të vlerësimit etik dhe profesional, për kandidatët e verifikuar, të cilët kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit që përfshin vitin e fundit kalendarik, përkatësisht vitin 2021.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, bazuar në të gjithë dispozitat ligjore dhe ato nënligjore të skemës së vlerësimit të gjyqtarëve, pas përfundimit të procedurës së verifikimit për plotësimin e tre kritereve ligjore të kandidimit, për 3 nga gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, i propozon sot mbledhjes plenare, fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar të detyruar (viti 2021), për gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}.

Për sa më sipër është përgatitur nga ana e Komisionit edhe relacioni dhe projektvendimi përkatës.

Në pikën e I-rë të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për vitin kalendarik 2021, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë. Theksoj se ky vlerësim është vlerësimi i dytë në radhë që është i domosdoshëm për t'u kryer në kushtet kur ligji kërkon që gjyqtarët duhet të kenë dy vlerësime të njëpasnjëshme, ndërkohë që vlerësimi i parë është ai i gradimit, për të cilin procedurat janë ende në shqyrtim e sipër nga ana e Komisionit. Procedurat e gradimit kanë filluar dhe pranë secilit relator po zhvillohet procedura e vlerësimit.

Në pikën e II-të e projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për relatorin, dhe ndërmjet dy nëpunësve të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional.

Në procedurën e shortit që do të zhvillohet për përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar, Komisioni ka vlerësuar që të përfshihen të tre anëtarët e Komisionit, duke siguruar një shpërndarje të barabartë të punës (një vlerësim secili anëtar). Ndërsa lidhur me numrin e nëpunësve që do të angazhohen në vlerësimin etik dhe profesional sipas këtij projektvendimi, propozohet të përfshihen në short nëpunësit përgjegjës për vlerësimin që janë angazhuar tashmë në vlerësimet e gjyqtarëve, znj. Esmerilda Habili dhe znj. Gilda Hoxha. Me qëllim ruajtjen e një ngarkese të barabartë pune midis dy nëpunësve gjyqësorë për vlerësimin, Komisioni propozon që znj. Esmerilda Habili të përfshihet vetëm në një procedurë vlerësimi, ndërsa znj. Gilda Hoxha në dy procedura vlerësimi.

Lidhur me procedurat e shortit, tashmë ne kemi një praktikë të konsoliduar në Këshill, kështu që të vijojmë nëse nga anëtarët e Këshillit nuk ka ndonjë pyetje lidhur me relacionin. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Ftoj administratën që të fillojë procesin e hedhjes së shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Në vazon e parë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve: znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Në vazon e dytë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës: znj. Esmerilda Habili (një shirit) dhe znj. Gilda Hoxha (dy shirita).

Në vazon e tretë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Brikena Ukperaj, znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa.

Pas përzgjedhjes nga procedura e shortit rezulton:

Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

***Naureda Llagami:*** Jemi dakord me shortin?

***Ilir Rusi:*** Dakord.

***Irena Plaku:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Dakord.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2021, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

1. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

2. Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

3. Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 29.03.2022)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për pakësimin e fondeve në sistemin gjyqësor, në zbatim të aktit normativ nr. 3, datë 12.03.2022, për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni i të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.<sup>3</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 14:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

<sup>3</sup> Cështje e cila ishte parashikuar të trajtohej e 8-ta në rendin e ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Drejtorisë së Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 3. Lorena Gerverni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 4. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Staf administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pakësimin e fondeve në sistemin gjyqësor, në zbatim të aktit normativ nr. 3, datë 12.03.2022, për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni i të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek dy akte që kanë të bëjnë me pjesën e buxhetit. Akti i parë ka të bëjë me pakësimin e fondeve në sistemin gjyqësor, në zbatim të aktit normativ nr. 3, datë 12.03.2022, për vitin 2022. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Xhevdet.

**Xhevdet Haxhiu:** Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Për shkak të situatës ekonomike në vend, Këshilli i Ministrave, në datë 14 mars ka nxjerrë aktin normativ nr. 3 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e shtetit 2022””. Bazuar në këtë akt normativ, si në të gjithë buxhetin e shtetit edhe në grupin buxhetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor është bërë pakësimi i shumës prej 130,152,100 lekë në shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2022, nga të cilat:

–Në programin 01110, në shumën prej 18,161,600 lekë;

–Në programin 01140 (QTI), në shumën prej 396,500 lekë;

–Në programin “Buxheti i gjykatave” 03310, në shumën prej 111,594,000 lekë.

Pra pakësimi i fondeve ka prekur fondet e miratuara në shpenzime personeli dhe në shpenzime operative për të tre programet.

Vlen të theksohet se në këtë akt normativ nuk na janë pakësuar fondet në shpenzime kapitale, pra në investime për të tre programet buxhetore të sistemit të drejtësisë.

Kështu, fondet buxhetore për sistemin gjyqësor bazuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë detajuar në datën 23.12.2021, bazuar në vendimin nr. 596 të Këshillit, duke u detajuar sipas tre programeve.

Relacionin besoj e keni të gjithë përpara, për të kursyer kohë, nuk po përmend detajimin e tyre që është bërë në atë kohë. Vlen të theksohet që në programin 03310 është mbajtur pa detajuar vlera prej 365,460 mijë lekë (në shpenzime personeli dhe në shpenzime operative), për t’u detajuar dhe përdorur gjatë vitit buxhetor për plotësim të nevojave të gjykatave. E theksova këtë vlerë për arsye se në programin 03310 “Buxheti i gjykatave”, pakësimet janë bërë në artikujt 600 dhe 601, të cilat do hiqen nga fondi pa i prekur buxhetet të cilat janë detajuar për gjykatat, do hiqen nga ato që janë të padetajuara në KLGJ, të cilat janë mbajtur për t’u detajuar pas detajimit të punonjësve shtesë, por edhe pas emërimit të magistratëve gjyqtarë që fillojnë shkollën në korrik. Ndërsa pjesa tjetër do shkurtohen nga artikulli 602 “shpenzime operative”, të cilat mbas një analize të buxheteve të gjykatave, në bashkëpunim me kryetarët e buxheteve nëpër gjykata, kemi arritur që të shkëpusim prej tyre mesatarisht 15% për çdo gjykatë, nga buxheti, për shpenzime korrente.

Kështu, për sa më sipër, pas shqyrtimit dhe miratimit të relacionit të përgatitur nga Departamenti i Administrimit të Buxhetit në Komision, i propozojmë seancës plenare shqyrtimin dhe miratimin e pakësimeve të fondeve buxhetore në shpenzime korrente, në shumën prej 130,152,100 lekë, për sistemin gjyqësor për vitin 2022, sipas programeve, si më poshtë:

Në programin 01110, pakësimin e fondeve në shumën prej 18,161,600 lekë (shpenzime paga, shpenzime sigurime shoqërore, shpenzime operative) sipas pasqyrës nr. 1 bashkëlidhur relacionit.

Në programin 01140, pakësimin e fondeve në shumën prej 396,500 lekë (shpenzime paga, shpenzime sigurime shoqërore, shpenzime operative) sipas pasqyrës nr.

2.

Në programin 03310, pakësimin e fondeve në shumën prej 111,594,000 lekë (shpenzime paga, shpenzime sigurime shoqërore, shpenzime operative) sipas pasqyrës nr.

3.

Ju faleminderit!

**Naureda Llagami:** Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-aktit?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e pakësimit të fondeve buxhetore në shpenzime korrente, në shumën prej 130,152,100 lekë, për sistemin gjyqësor për vitin 2022, sipas programeve, si më poshtë:

Në programin 01110, pakësimin e fondeve në shumën prej 18,161,600 lekë, nga të cilat:

- shpenzime paga në shumën prej 4,775,000 lekë;
- shpenzime sigurime shoqërore në shumën prej 625,000 lekë;
- shpenzime operative në shumën prej 12,761,600 lekë, sipas pasqyrës nr. 1.

Në programin 01140, pakësimin e fondeve në shumën prej 396,500 lekë, nga të cilat:

- shpenzime paga në shumën prej 137,500 lekë;
- shpenzime sigurime në shumën prej 25,000 lekë;
- shpenzime operative në shumën prej 234,000 lekë, sipas pasqyrës nr. 2.

Në programin 03310, pakësimin e fondeve në shumën prej 111,594,000 lekë, nga të cilat:

- shpenzime paga në shumën prej 57,569,000 lekë;
- shpenzime sigurime në shumën prej 7,000,000 lekë;
- shpenzime operative në shumën prej 47,025,000 lekë, sipas pasqyrës nr. 3.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 29.03.2022)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime kapitale (investime) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni i të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.<sup>4</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 14:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>4</sup> Cështje e cila ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta në rendin e ditës.

**10. Marçela Shehu** (anëtare)

**11. Yllka Rupa** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Drejtorisë së Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 3. Lorena Gerverni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 4. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Staf administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime kapitale (investime) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për vitin 2022”, i përgatitur nga Komisioni i të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e dytë që ka të bëjë me transferimin e fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime kapitale (investime) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për vitin 2022.

Prapë fjalën ia jap z. Haxhiu.

**Xhevdet Haxhiu:** Faleminderit, Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me shkresën nr. 108, datë 11.03.2022, ka paraqitur një kërkesë për transferim fondesh brenda shpenzimeve kapitale, për këtë vit buxhetor.

Ju bëj me dije se më përpara, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në 18 shkurt, na ka vënë në dijeni për një defekt në sistemin qendror të ngrohje – ftohjes së godinës ku ajo zhvillon aktivitetin e saj si dhe propozonte zëvendësimin e sistemit qendror të ngrohje

– ftohjes, me kondicionerë split individualë për të gjithë ambientet e gjykatës, por vlerësojmë se në shkresën e parë gjykata nuk propozonte dhe nuk kishte vlerësuar asnjë mënyrë zgjidhjeje të kësaj problematike brenda buxhetit të saj të miratuar për këtë vit buxhetor.

Më vonë, gjykata na ka sjellë shkresën me nr. 108, ku pas bërjes së analizës së shpenzimeve buxhetore për zërin “investime” në buxhetin e tyre, ka kërkuar të transferohen fonde brenda artikullit 231. Kështu, përgjatë vitit buxhetor kishin parashikuar, edhe në kërkesat buxhetore por edhe në analizat që janë bërë nga Këshilli deri në miratimin e buxhetit dhe detajimin e buxhetit në dhjetor të vitit 2021 për buxhetin e vitit 2022, kishin kërkuar për të blerë pajisje zyre në shumën 400,000 lekë për “orendi zyre” dhe “pajisje për sistemin e sigurisë” dhe në kodin “Blerje pajisje elektronike”, ku kishin kërkuar “pajisje kompjuterike” dhe pajisje të tjera të zyrës prej 200,000 lekë.

Për këtë arsye, duke qenë se këto fonde nuk i kishin përdorur akoma, ato kërkojnë për këtë problematikë të dalë papritur, t’i kalojnë në kodin “Blerje pajisje zyre” të gjitha dhe në nënartikullin “Pajisje dhe instalim kondicionerësh” për shumën në total 840,000 lekë (aq sa është edhe fondi i tërë për shpenzime kapitale investime për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë për vitin buxhetor 2022.)

Për sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, pasi mori në shqyrtim dhe miratoi relacionin e përgatitur nga Departamenti i Administrimit dhe Programimit të Buxhetit, i propozon seancës plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, shqyrtimin dhe miratimin e transferimit të fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime kapitale (investime) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, duke pakësuar nga kodi “Blerje pajisje zyre” shumën prej 400,000 lekë dhe nga kodi “Blerje pajisje elektronike” shumën prej 440,000 lekë, duke shtuar kodin “Blerje pajisje zyre” në nënartikullin “Pajisje dhe instalim kondicionerësh” në shumën prej 840,000 lekë, sipas pasqyrës së mëposhtme. Pasqyrën e kam lënë për t’u orientuar të gjithë anëtarët për të gjithë veprimet e mësipërme që ka bërë Departamenti i Administrimit të Buxhetit.

Ju faleminderit!

*Alban Toro*: Mundem?



**Naureda Llagami:** Po, zoti Toro!

**Alban Toro:** Në kushtet kur nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor prej kohësh është theksuar nevoja e modernizimit të infrastrukturës së sistemit të sigurisë së gjykatave, shoh që një nga zërat apo artikujt e cenuar për blerjen e kondicionerëve është pikërisht zëri i “Pajisjeve për sistemin e sigurisë”, që mendoj është në kundërshtim jo vetëm me vullnetin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe jo vetëm që zëra të tillë janë modest për shkak të kontributit të buxhetit të shtetit, por edhe në rastet kur ato janë modeste, çuditërisht nga gjykatat, fondi i parë i cili sugjerohet për t’u cenuar është pikërisht ky fond.

Kështu që në këto kushte, unë do të propozoja që fondi për “Pajisje dhe instalim kondicionerësh” të mbetet në vlerën 740,000 lekë, duke mos përfshirë në të nënartikullin 231 “Pajisje për sistemin e sigurisë” që është në vlerën 100,000 lekë. Pra ky fond të mbetet në vlerën 740,000 lekë dhe të mbetet i pacenuar fondi 100,000 lekë i parashikuar për “Pajisje për sistemin e sigurisë”. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Po Xhevdet!

**Xhevdet Haxhiu:** Unë vlerësoj që analiza buxhetore dhe nevoja e ngutshme që i ka dalë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në cilësinë e njësisë shpenzuese të nivelit të dytë është detyrë dhe përgjegjësi e saj që të përgatisë projektpropozime ose të kërkojë propozime për rialokim fondesh/ transferim fondesh brenda buxhetit të tyre, aty ku ato e vlerësojnë më të nevojshme dhe më të ngutshme.

Dua të bëj me dije se gjykata, në konsultimin që kemi bërë për kërkesat buxhetore të vitit në vazhdim që ne s’kemi filluar dhe jemi në përfundim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka paraqitur kërkesë edhe për një fond tjetër për diferencë në këtë fond, për të blerë kondicionerë të tjerë plus, për të plotësuar nevojat e gjykatës me tipin e kondicionerëve split, për arsye, sepse kostoja e sistemit të ngrohje–ftohjes, nga një dokumentacion që kanë paraqitur ato pranë Drejtorisë së Investimeve, është në një vlerë shumë të konsiderueshme. Kështu që në vlerësimin tim, ne jemi bazuar tek ajo detyrë dhe

përgjegjësi që ka gjykata në cilësinë e njësisë shpenzuese të nivelit të dytë. Megjithatë, kjo është në diskretin e Këshillit për të vendosur. Kjo është sa për sqarim.

**Naureda Llagami:** Nëse nuk kemi më diskutime?

**Alban Toro:** Kryetare, ishte propozimi im në fakt që duhet votuar, që fondi i propozuar nga Komisioni në vlerën 840,000 lekë të zbritet në vlerën 740,000 lekë, duke mos cenuar fondin e sigurisë. Pra të hedhim në votë mendoj propozimin tim që vlera të jetë 740,000 lekë.

**Naureda Llagami:** Dakord. Hedhim në votë propozimin e Albanit mbi pakësimin e vlerës së fondit.

**Brikena Ukperaj:** Më fal Kryetare, kam diçka.

Si do ta përcaktojmë ne pse një vlerë më e vogël? Normalisht, gjykata që e ka propozuar duhet të ketë marrë ekspertizë kam përshtypjen. Pse 700 dhe jo 600? Ky është merak.

**Alban Toro:** Brikena, kanë bërë një studim të tregut dhe kanë menduar që vlera limit për ta tenderuar më pas për blerje kondicionerësh është 800,000 lekë, që në fakt duket vlerë e vogël për kondicionerë të cilësisë së lartë, megjithatë ata e kanë bërë këtë studim dhe unë nuk do të guxoja që të hyja në studimin që kanë bërë, sepse mbajnë përgjegjësi, por ajo që unë evidentova është fakti që nëse nga ana e Këshillit evidentohet që sistemi i sigurisë nëpër gjykata është i dobët dhe rudimental për shkak të kontributit të vogël të buxhetit të shtetit në këtë drejtim, nuk duhet të kontribuojmë që ne ta zvogëlojmë akoma edhe më shumë për faktin e thjeshtë se një gjykatë vlerëson që sistemi i saj i sigurisë është në nivele optimale përderisa e ka cenuar këtë fond, kur në parashikimin e buxhetit të viteve '22-'23 ata kanë evidentuar faktin e kërkesave në këtë lloj zëri, pra në sistemin e sigurisë. Kështu që është thjesht propozimi im që ky fond të mos cenohet dhe të përfshihet në vlerën e blerjes së kondicionerit, pra në shumë e përgjithshme 840,000 lekë, por t'i zbritet kësaj vlere, dhe vlera për blerjen e kondicionerit të mbetet 740,000

lekë. Në vitin që vjen ata mund të parashikojnë kërkesë për shtesë për kondicionerë, por të paktën siguria në gjykatë të mos dobësohet akoma më shumë sepse mungojnë investimet përkatëse.

**Ilir Rusi:** Kryetare, mundet të bëj një koment?

**Naureda Llagami:** Po, Ilir!

**Ilir Rusi:** Faleminderit, Kryetare!

Përshëndetje, të nderuar anëtarë!

Unë isha një nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor në analizën e Gjykatës së Lushnjës dhe të Fierit, dhe nga parashtruesat e bëra nga trupa gjyqësore, e cila vlen për t'u theksuar, ishin femra, ishte edhe një ditë e ftohtë dhe vërtetë ishte një situatë emergjente në raport me krijimin e kushteve optimale për të ushtruar një detyrë kaq fisnike dhe po aq të rëndësishme në raport me misionin dhe qëllimin që ka gjykata. Natyrisht që koleget tona gjyqtare kanë përgjegjshmërinë e duhur dhe kanë përcaktuar si nevojë imediate caktimin e një fondi për blerjen e një mjeti të domosdoshëm, siç është ngrohja dhe ftohja. Njëkohësisht bëj me dije që ky është një fond limit i cili për shkak edhe të tenderimit ai mund edhe të ulet dhe këto fondet e mbetura mund të rialokohen përsëri. Gjykata e ka në vëmendje edhe funksionalitetin e elementëve të sigurisë së saj. Me këtë parashtrësë doja të thosha që nëse do kalojmë në procesin e votimit, do isha kundër propozimit të bërë nga kolegu Toro. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Kemi më diskutim?

Nëse jo, hedhim edhe një herë në votim propozimin e zotit Toro.

**Ilir Rusi:** Kundër propozimit të bërë nga kolegu Toro, për arsyet e parashtruara.

**Irena Plaku:** Kundër. I qëndroj edhe unë arsyeve që dha Iliri. Përderisa vetë gjykata ka çmuar që e ka më të domosdoshme këtë fond, besoj se nuk mund t'i ulim fondin për kondicionerët në këtë rast, për një zë tjetër që në këtë moment gjykata e ka vlerësuar jo të domosdoshme. Është përgjegjësi e tyre, kështu që...

**Dritan Hallunaj:** Kundër, duke argumentuar faktin (për të mos rënë në përsëritje) që tha Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, që është konstatuar kjo problematikë dhe kjo kërkesë dhe gjithashtu edhe fakti që kërkesa që ato kanë bërë është parashtruar në këtë kuadër. Pra ato vetë kanë vlerësuar që të kenë këtë dhe të heqin dorë nga ajo pjesa tjetër.

**Ridvan Hado:** Kundër, me arsyetimin e parafolësve. Kështu që për të njëjtat arsye, vota ime është kundër.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Kundër propozimit. Kam votuar në Komision.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Yllka Rupa:** Kundër propozimit të zotit Toro.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Klodian Kurushi:** Pro propozimit të Albanit.

**Naureda Llagami:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

**Illir Rusi:** Dakord me propozimin e Komisionit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Pjesërisht dakord, përveç pjesës për të cilën unë propozova që të reduktohej nga vlera e përgjithshme, pra vlerës 100,000 lekë që i takon pajisjes për sistemin e sigurisë.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Pjesërisht dakord me propozimet e Komisionit.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e transferimit të fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime kapitale (investime) në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Lushnjë, duke pakësuar nga kodi i projektit 18AD801 “Blerje pajisje zyre” shumën prej 400,000 lekë (“Orendi zyre” 300,000 lekë dhe “Pajisje për sistemin e sigurisë” 100,000 lekë) dhe kodi i projektit 21AC401, “Blerje pajisje elektronike” shumën prej 440,000 lekë (“Pajisje kompjuterike” 240,000 lekë dhe “Pajisje të tjera zyre” 200,000 lekë), në total shumën prej 840,000 lekë, si dhe duke shtuar në kodin e projektit 18AD801 “Blerje pajisje zyre”, në nënartikullin 231 4170 “Pajisje dhe instalim kondicionerësh” shumën prej 840,000 lekë, sipas pasqyrës bashkëlidhur.

2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 29.03.2022)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e kërkesës së gjyqtarit {...} për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit me pagesë”, i përgatitur nga Komisioni i Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).<sup>5</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 14:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Marçela Shehu</b>  | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>5</sup> Cështje e cila ishte parashikuar të trajtohej e 7-ta në rendin e ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Staf administrativ i KLGJ-së.*

**RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e kërkesës së gjyqtarit {...} për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit me pagesë”, i përgatitur nga Komisioni i Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i fundit për sot, i cili ka të bëjë me miratimin e kërkesës së gjyqtarit {...} për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit me pagesë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

*Brikena Ukperaj:* Faleminderit, zonja Kryetare!

Në datë 10.03.2022, me nr. {...} prot., është regjistruar në Këshillin e Lartë Gjyqësor kërkesa e z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për dhënien e një lejeje të paguar me qëllim kryerjen e veprimtarisë së këshillimit ligjor pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg, me shkëputje nga detyra e gjyqtarit.

Në kërkesën e tij z. {...} parashtron se është përzgjedhur nga Këshilli i Evropës për t’u angazhuar pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Strasburg, nga data 4 prill 2022 deri me datën 1 korrik 2022. Gjatë këtij angazhimi ai parashtron se do të kryejë detyra këshillimore në mbështetje të sistemit të administrimit të Sekretarisë së

Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Strasburg, të tilla si kërkimi ligjor, hartimi i raportimeve, përgatitja e korrespondencës, etj.

Në kërkesën e tij z. {...}, parashtron kushtet e zhvillimit të veprimtarisë në dispozicion të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), duke u atashuar pranë organeve të Këshillit të Evropës, çka përbën një mundësi shumë të mirë për të fituar përvojë profesionale dhe kontakte në mjedisin e organizatës ndërkombëtare, në rastin konkret, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa kjo e fundit mund të përfitojë nga aftësitë dhe ekspertiza specifike që zyrtarët mund t'i sjellin asaj, duke u konsideruar si periudhë vjetërsie në punën e zyrtarit. Po ashtu parashtrohet se kjo veprimtari nuk paguhet nga GJEDNJ, sepse duhet të mbulohet nga ana e vendeve anëtare, pasi nga ana e Këshillit të Evropës ai do të përfitojë vetëm shpërblimin në formë dietash për udhëtimin dhe shpenzimet e qëndrimit.

Sa i përket motivit mbi të cilin bazohet kërkesa për miratimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie, në kërkesën e tij z. {...} parashtron, ndër të tjera, se : “... puna e zhvilluar do të konsistojë në qenien këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Strasburgut, një veprimtari plotësisht e pajtueshme me atë të magjistratit në kuptim të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të drejtën e magjistratit për të zhvilluar veprimtari pune në gjykata ndërkombëtare; si dhe e mbështet kërkesën në interesin për punësimin, zhvillimin dhe thellimin e njohurive në fushën e Konventës Evropiane të të Drejtave the Lirive Themelore të Njeriut, e cila ka një status ligjor si e drejtë ndërkombëtare në nivel kushtetues ose pas kushtetues, çka do të përbënte një përvojë të rëndësishme në karrierën dhe formimin e tij profesional.

Bashkëlidhur kërkesës z. {...} ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

1. Letër e përzgjedhjes së gjyqtarit {...} nga Këshilli i Evropës nr. {...}/2022, datë 10.03.2022, në përmbajtje të së cilës evidentohet si më sipër, qëllimi dhe natyra e punës që do të kryejë z. {...} pranë GJEDNJ.

2. Shkresë me nr. {...} prot., datë 15.03.2022, e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i cili jep pëlqimin për atashimin pranë GJEDNJ për periudhën 04.04.2022 deri në 01.07.2022 të gjyqtarit {...}. Në këtë shkresë zëvendëskryetari i gjykatës, edhe pse evidenton ngarkesën e lartë të gjykatës, duke iu referuar numrit të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin pranë saj, kohën e shkurtër të angazhimit të z. {...} në



veprimtari jashtë funksionit, të drejtën e tij për të zhvilluar karrierën si magjistrat dhe interesat e drejtësisë, parashtron se shkëputja e tij nga detyra e gjyqtarit për një periudhë 3-mujore nuk do të cenonte funksionalitetin e gjykatës.

3. Shkresë me nr. {...} prot., datë 11.03.2022 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nëpërmjet së cilës është përcjellë informacion për ngarkesën e gjyqtarit. Nga të dhënat e dërguara rezultojnë se gjyqtari ka 160 çështje të mbartura nga viti i mëparshëm, 140 çështje të regjistruara të reja, 67 çështje të përfunduara dhe 233 çështje në shqyrtim.

Në lidhje me këtë kërkesë, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale vlerëson se:

Pavarësisht se objektin e kërkesës gjyqtari e titullon “Kërkesë për leje të paguar”, në thelb kërkesa e tij drejtuar Këshillit, i referohet miratimit të një veprimtarie jashtë funksionit me pagesë që ai do të kryejë i përzgjedhur për të ushtruar këshillim ligjor pranë GJEDNJ-së. Në këtë kuadër, kërkesa e tij u trajtua në përputhje me nenin 143 të Kushtetutës si dhe nenin 9 të Ligjit për Statusin.

Në këtë të fundit parashikohet se magjistrati lejohet të kryejë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, vetëm nëse këto veprimtari përmbushin kushtet si më poshtë:

- a) janë në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
- b) nuk krijojnë perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
- c) nuk bien ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikente të funksioneve;
- ç) nuk bien ndesh me qëllimin për të cilin është ulur ngarkesa e punës;
- d) në rast se shpërblimi për veprimtaritë jashtë funksionit përfshin çdo lloj dhe formë pagese, shpërblim financiar ose kompensim, të cilat nuk tejkalojnë rregullat e zakonshme të tregut;
- dh) nuk janë të papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohen sipas këtij ligji”.

Sa i përket veprimtarive të paguara jashtë funksionit, në pikën 5 të nenit 9, të Ligjit për Statusin, parashikohet miratimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, para se magjistrati të pranojë kryerjen e saj. Ndërkohë në pikën 4 të nenit 9 përcaktohen

dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën me shkrim të magjistratit dhe të dhënat e domosdoshme që ato duhet të përmbajnë me qëllim vlerësimin mbi bazueshmërinë e kërkesës për dhënie miratimi për ushtrimin e veprimtarisë konkrete.

Në lidhje me procedurën dhe elementë të tjerë që kanë të bëjnë me trajtimin e kërkesës për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit, ne pikën 10 të nenit 9, të Ligjit për Statusin, parashikohet se: “Bazuar në parimin e barazisë dhe të proporcionalitetit, Këshilli miraton rregulla të detajuara për veprimtaritë jashtë funksionit”. Këshilli aktualisht nuk ka miratuar rregulla të detajuara për veprimtaritë jashtë funksionit. Për pasojë, kërkesa e z. {...} u trajtua në përputhje me parashikimet e nenit 143 të Kushtetutës dhe nenit 9 të Ligjit për Statusin, duke pasur në vëmendje parimet e proporcionalitetit dhe barazisë.

Miratimi i kërkesës për ushtrimin e një veprimtarie jashtë funksionit, me ose pa pagesë, bëhet pas verifikimit dhe vlerësimin të kushteve të përgjithshme, të parashikuara në nenin 9 pika 1 të Ligjit për Statusin. Ndërkohë për ushtrimin e veprimtarive të paguara jashtë funksionit, kërkesa me shkrim, bazuar në parashikimet e nenit 9, pika 4 të Ligjit për Statusin, duhet të shoqërohet edhe me të dhëna apo dokumentacion lidhur me (i) përshkrimin e natyrës dhe kohëzgjatjes së veprimtarisë; (ii) masën e shpërblimit të këtyre veprimtarive dhe (iii) ngarkesën në punë të gjyqtarit si dhe përmbushjen në kohë të detyrave përgjatë 12 muajve të mëparshëm.

Në rastin konkret, lidhur me plotësimin e kushteve si më sipër si dhe paraqitjen e të dhënave dhe dokumentacionit të nevojshëm për vlerësimin e bazueshmërisë së kërkesës, rezulton si vijon:

i) Gjyqtari {...} ka paraqitur kërkesë me shkrim në datë 10.03.2022, duke kërkuar miratimin e Këshillit për ushtrimin e veprimtarisë së këshilltarit ligjor pranë GJEDNJ, duke përcaktuar edhe periudhën e ushtrimit të veprimtarisë;

ii) Kërkesa përmban përshkrimin e veprimtarisë jashtë funksionit për të cilën kërkohet miratimi, si dhe përshkrimin konkret të detyrave kryesore që përfshin ushtrimi i veprimtarisë konkrete. Gjyqtari ka referuar në kërkesën me shkrim, duke e shoqëruar atë dhe me dokumentacionin e nevojshëm, se natyra e veprimtarisë e cila synohet të ushtrohet konsiston kryesisht në kryerjen e detyrave këshillimore në mbështetje të sistemit të administrimit të Sekretarisë së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,

Strasbourg, të tilla si kërkimi ligjor, hartimi i raportimeve, përgatitja e korrespondencës, etj.;

iii) Veprimtaria jashtë funksionit që kërkohet të ushtrohet në rastin konkret, është në përputhje me parashikimet e nenit 9, pika 1, shkronja a) të Ligjit për Statusin përbën një veprimtari e cila nuk cenon dinjitetin e funksionit të magjistratit nëse i referohemi natyrës së saj, po ashtu edhe qëllimit të kësaj veprimtarie, që konsiston në kryerjen e detyrave këshillimore, ligjore;

iv) Veprimtaria në rastin konkret, duke konsideruar natyrën e saj, nuk krijon asnjë perceptim të ndikimit ose njëanshmërisë në ushtrimin e funksionit gjyqësor, pasi veprimtaria këshillimore pranë një gjykate ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, jo vetëm që nuk krijon objektivisht dhe as potencialisht ndonjë perceptim për njëanshmëri apo ndikim për ushtrimin e funksionit gjyqësor, përkundrazi përbën një vlerë të shtuar në formimin profesional të magjistratit, e cila do të përkthehet në sjelljen e një përvoje specifike dhe të dobishme për sistemin gjyqësor shqiptar, duke krijuar njëkohësisht edhe hapësirë për të dhënë një kontribut profesional dhe dinjitoz pranë organizatës ndërkombëtare në të cilën ai do të ushtrojë këtë veprimtari;

v) Gjatë kryerjes së saj veprimtaria nuk bie ndesh me interesat thelbësore të funksionit dhe nuk cenon ushtrimin në mënyrë efçente të detyrës së gjyqtarit, pasi në rastin konkret, për shkak të vendit në të cilin do të ushtrohet kjo veprimtari (jashtë territorit shqiptar) si dhe natyrës së veprimtarisë e cila, për periudhën përkatëse është me kohë të plotë, ajo do të passjellë ndërprerjen e përkohshme të ushtrimit të funksioneve gjyqësore të gjyqtarit pranë Gjykatës ku ai ushtron funksionin aktualisht. Për pasojë, gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie, e cila nuk do të zhvillohet paralelisht me funksionet gjyqësore, ajo nuk mund të ndikojë në afatet dhe efçencën e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit;

vi) Veprimtaria nuk bie ndesh me qëllimin për të cilin është ulur ngarkesa e punës, pasi në rastin konkret, sikurse u analizua më sipër, gjatë periudhës 3-mujore në të cilën gjyqtari do të ushtrojë veprimtarinë jashtë funksionit, nuk do të ushtrojë paralelisht funksionet gjyqësore, dhe për pasojë, nuk gjen aplikim ulja e ngarkesës në punë;

vii) Veprimtaria që gjyqtari do të ushtrojë është një veprimtari e paguar, por që përmban disa specifika. Konkretisht, në bazë të Rezolutës së Këshillit të Evropës

CM/Res(2012), datë 15.02.2012, zyrtarët e transferuar do të qëndrojnë në punë ose do të paguhet nga shteti anëtar nga i cili ai/ajo është dërguar gjatë gjithë periudhës së dërgimit dhe nuk do të marrin asnjë rrogë nga Këshilli i Evropës. Kjo rezolutë është e mbështetur në nenin 16 të Statutit të Këshillit të Evropës, akt i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, duke u bërë pjesë e sistemit të brendshëm sipas nenit 122 dhe 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në nenin 16 të Statutit të Këshillit Evropës parashikohet se: “Komiteti i Ministrave, në përputhje me dispozitat e neneve 24, 28, 30, 32, 33 dhe 35, në lidhje me kompetencat e Asamblesë Konsultative, vendosin me fuqi detyruese të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me organizimin dhe rregullimet e brendshme të Këshillit të Evropës. Për këtë qëllim, Komiteti i Ministrave miraton rregullime të tilla financiare dhe administrative siç mund të jetë e nevojshme”.

Pra, rezoluta parashikon qartë mbulimin e pagesës së nëpunësit të atashuar nga shteti anëtar nga i cili nëpunësit janë dërguar, gjatë gjithë periudhës së dërgimit. Në kuadër të këtij detyrimi, organet e shtetit shqiptar, pa përjashtim, kanë detyrimin për të vijuar me pagesën e nëpunësve të cilët atashohen derisa këta vazhdojnë periudhën e atashimit pranë organeve të Këshillit të Evropës. Kjo do të thotë se përgjatë periudhës së atashimit të gjyqtarit pranë Gjykatës së Strasburgut, duhet të vijojë të paguhet nga gjykata respektive, në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare për Republikën e Shqipërisë, si një detyrim ky që është i zbatueshëm në rastin konkret.

Në kushtet kur gjyqtari nuk do të marrë pagë për punën e kryer nga Këshilli i Evropës dhe do të vijojë të trajtohet me pagën për funksionin e gjyqtarit nga gjykata përkatëse, nuk ka vend për vlerësimin nëse ky trajtim tejkalon rregullat e zakonshme të tregut.

Sipas akteve të administruara në kuadër të trajtimit të kësaj kërkesë, rezulton se nga ana e Këshillit të Evropës gjyqtari do të trajtohet me pagesë vetëm në formën e dietës që përfshin shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet thelbësore të qëndrimit në vendin e ushtrimit të funksionit, shpërblime të cilat nuk përbëjnë trajtim financiar të diferencuar, për sa kohë që nga natyra e tyre konsistojnë në mbulimin e kostove të udhëtimit dhe të jetesës dhe nuk përbëjnë të ardhura apo shpërblim për ushtrimin e funksionit;

viii) Veprimtaria e këshilltarit ligjor të atashuar pranë GJEDNJ-së, nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe po ashtu nuk përbën

veprimtari të ndaluar sipas Ligjit për Statusin. Veprimtaritë e papajtueshme dhe ato të ndaluara për magjistratët, parashikohen në mënyrë të detajuar në nenet 6, pika 1 dhe 7, pika 4 të Ligjit për Statusin. Në rastin konkret, duke iu referuar (i) natyrës së institucionit pranë të cilit magjistrati do të atashohet; (ii) veprimtarisë së këtij institucioni që konsiston në veprimtari gjyqësore në fushën e të drejtave të njeriut; (iii) natyrës së punës apo veprimtarisë që magjistrati do të kryejë sipas përshkrimit të saj referuar akteve të administruara bashkëlidhur kërkesës dhe (iv) qëllimit të kësaj veprimtaria konkrete; nuk ka asnjë të dhënë që të krijojë dyshime se veprimtaria konkrete mund të përmbajë elementë që bien ndesh me parashikimet e nenit 6 dhe 7 të Ligjit për Statusin, që parashikojnë rastet e papajtueshmërisë me funksionin e magjistratit dhe kufizimet për shkak të funksionit.

ix) Sa i përket cenimit të funksionalitetit të gjykatës, sipas mendimit të kryetarit të dërguar më datë 15.03.2022, rezulton se ndërprerja e ushtrimit të funksioneve e gjyqësore të gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për një periudhë 3–muajore, nuk cenon funksionalitetin e gjykatës. Referuar mendimit të kryetarit dhe të dhënave për ngarkesën e tij, rezulton se pavarësisht ngarkesës së gjykatës, numri i gjyqtarëve që ushtojnë funksionin pranë kësaj gjykate si dhe koha e shkurtër e shkëputjes nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, nuk do të sjellë pasoja në funksionalitetin e saj. Komisioni, i vetëdijshëm për ngarkesën e përgjithshme aktualisht të të gjitha gjykatave, në vlerësimin lidhur me cenimin e funksionalitetit të gjykatës, në rastin konkret, veç sa më sipër, merr në konsideratë edhe nevojën për të pasur ekspertizën vendase në GJEDNJ si dhe të drejtën e magjistratit për të zhvilluar karrierën e tij, duke synuar të krijojë një balancë të drejtë mes nevojave të gjykatës dhe të drejtës së gjyqtarit për të ushtruar veprimtarinë konkrete, në respektim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit.

Për sa më sipër rezulton se kërkesa e gjyqtarit {...} për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit, të këshillimit ligjor pranë GJEDNJ–së, për një periudhë 3-mujore, përmbush kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 9, të ligjit nr. 96/2016 si dhe përbën veprimtari e cila është në përputhje me parashikimet e nenit 143 të Kushtetutës.

Sa i përket çështjeve gjyqësore të cilat gjyqtari {...} do të këtë në shqyrtim në momentin e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë jashtë funksionit, duke konsideruar (i) ngarkesën aktuale të gjyqtarit; (ii) kohëzgjatjen e veprimtarisë, gjatë së cilës gjyqtari nuk

mund të ushtrojë funksionin e gjyqtarit; (iii) interesin e ligjshëm të palëve ndërgjyqëse për një proces i cili zhvillohet brenda afateve të arsyeshme; (iv) garantimin e parimit të efektivitetit në veprimtarinë e gjykatave dhe veçanërisht parimit të dhënies së drejtësisë në kohë dhe pa vonesa dhe (v) parashikimet e nenit 25, pika 3, shkronja d) të ligjit 98/2016, ku rindarja e çështjeve me short lejohet kur është e nevojshme për shkaqe të justifikuara, Komisioni propozon që çështjet që gjyqtari {...}, do të ketë në shqyrtim në datë 04.04.2022, të rindahen me short midis gjyqtarëve të tjerë.

Referuar sa më sipër Komisioni i propozon mbledhjes plenare:

Miratimin e kërkesës së z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për ushtrimin e veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, të këshillimit ligjor pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg, me shkëputje nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, për periudhën 01.04.2022 deri 04.07.2022.

Periudha e ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, si më sipër, konsiderohet vjetërsi në detyrë si magjistrat.

Gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, gjyqtari do të përfitojë pagën si dhe do t'i paguhen kontributet për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe për pensionin suplementar. Pagesa e tyre duhet të kryhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, parashikim që në projektvendim saktësohet në një pikë të veçantë të tij.

Rindarjen me short të të gjitha çështjeve që gjyqtari {...} ka në shqyrtim në datë 04.04.2022.

Në relacion parashikohet edhe kompetenca e mbledhjes plenare për trajtimin e çështjes, efektet e këtij akti si një akt individual si dhe e drejta e ankimit.

Është përgatitur edhe projektvendimi ku saktësohet edhe periudha e ushtrimit të veprimtarisë jashtë funksionit që është 04.04.2022 deri në 01.07.2022, referuar të gjithë praktikës së depozituar nga gjyqtari sipas dokumentacionit të përcjellë atij nga ana e Këshillit të Evropës.

Faleminderit!

*Naureda Llagami*: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim mbi projekt-aktin.

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

**Ilir Rusi:** Pro propozimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

Do doja të bëja vetëm një koment. Në kushtet kur akti nënligjor që rregullon në mënyrë të detajuar mënyrën e ushtrimit të veprimtarive jashtë funksionit të gjyqtarëve ende nuk është miratuar nga Këshilli, do të vlerësoja që standardi i vendosur sot nga Këshilli, me këtë propozim që mund të kalojë edhe në vendim, të konsiderohet në momentin e hartimit dhe miratimit të rregullores përkatëse. Jam dakord me propozimin.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për ushtrimin e veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, të këshillimit ligjor pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg, me shkëputje nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, për periudhën 04.04.2022 deri 01.07.2022.

2. Periudha e ushtrimit të veprimtarisë së paguar jashtë funksionit, të këshillimit ligjor pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg, përbën vjetërsi në detyrë si magjistrat.

3. Gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë jashtë funksionit, gjyqtari z. {...}, përfiton pagën, si dhe pagesën e kontributeve për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe për pensionin suplementar.

4. Rindarjen me short të të gjitha çështjeve që gjyqtari {...} ka në shqyrtim në datë 04.04.2022.

5. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

6. Ngarkohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për zbatimin e këtij vendimi, bashkë me efektet financiare të përcaktuara në pikën 3 të tij.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

Me këtë akt përfundojmë mbledhjen për sot.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**